

Aneksi 1

Perkufizime & Interpretime

|                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|--------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Shqiperia                            | nenkupton Republiken e Shqiperise;                                                                                                                                                                                                                                                |
| Arrij                                | nenkupton ne lidhje me nje Testim, kalimin e suksesshem te nje testimi pa probleme gjate Testimit dhe ne lidhje me nje Pikesynim, nenkupton permbushjen e veprimtarise apo detyres se perfaqesuar nga Pikesynimi dhe shprehja "Arritur" do te interpretohet ne perputhje me kete; |
| Kontrate                             | nenkupton kete Kontrate Koncesioni.                                                                                                                                                                                                                                               |
| Ligji i zbatueshem                   | nenkupton cdo akt ligjor dhe nenligjor te zbatueshem te Republikes se Shqiperise, ne fuqi dhe ne veprim kohe pas kohe gjate Periudhes se Koncesionit.                                                                                                                             |
| Dite pune                            | nenkupton nje dite gjate se ciles ne Republiken e Shqiperise punohet, me perjashtim te festave zyrtare dhe fundjavave.                                                                                                                                                            |
| Ndryshim                             | nenkupton cdo ndryshim te kesaj Kontrate;                                                                                                                                                                                                                                         |
| Procedura e Kontrollit te Ndryshimit | nenkupton proceduren per te ndryshuar kete Kontrate, sikurse eshte percaktuar ne Aneksin 6 (Procedura e Kontrollit te Ndryshimit);                                                                                                                                                |
| Kerkesa per Ndryshim                 | nenkupton nje kerkese me shkrim per nje ndryshim te kontrates e cila do te jete thelbesisht ne formen e percaktuar ne Aneksin 6 (Procedura e Kontrollit te Ndryshimit);                                                                                                           |
| Koncesioni                           | Nenkupton dhenien nga Autoriteti te se drejtes eksluzive sic percaktohet ne Nenin 3;                                                                                                                                                                                              |
| Koncesionari                         | Nenkupton Bashkimin e Perkohshem te Shoqerive: "Albsale" S.H.A., "Hodaj" S.H.P.K., "Ansi" S.H.P.K., "V&K" S.H.P.K." dhe "Oro DI Sicilia" s.r.l.                                                                                                                                   |
| Shoqeria koncesionare                | nenkupton shoqerine shqiptare te themeluar nga                                                                                                                                                                                                                                    |

|                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                           | Koncesionari per zbatimin e Koncesionit ne perputhje me kete Kontrate;                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Tarifa e Koncesionit      | nenkupton shumen e pagueshme nga Koncesioneri ndaj Autoritetit Kontraktues per te drejtat dhe privilegjet e dhena ne kete Kontrate, ne shumat dhe menyren e percaktuar ne Nenin 16.1 dhe 16.2 (Tarifa e Koncesionit) te kesaj Kontrate;                                                                                                                             |
| Te Drejtat e Koncesionit  | nenkupton te drejtat e per te zbatuar Projektin;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Periudha e Koncesionit    | Do te kete kuptimin qe i eshte dhene asaj ne Nenin 3.1 te kesaj Kontrate.                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Personeli i Koncesionarit | nenkupton te gjitha punonjesit, agjentet, keshilltaret dhe kontraktoret e Koncesionerit dhe/ose te çdonjerit nga Nen-kontraktoret;                                                                                                                                                                                                                                  |
| Informacioni Konfidencial | nenkupton çfaredo informacioni, sido qe te perçohet, qe ka lidhje me çeshtje biznesi, pune, zhvillime, sekrete tregtare, njohuri, personelin dhe furnitoret e seciles Pale si dhe çdo informacion tjeter qe eshte bere e qarte qe eshte konfidencial (pavaresisht nese atij i eshte vendosur shenja "konfidencial") ose qe do te konsiderohej pa dyshim si i tille; |
| Autoriteti                | nenkupton Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes ose cdo Ent Shteteror i cili do te kete kompetencen lidhur me objektin e Koncesionit.                                                                                                                                                                                                                   |
| Viti i Kontrates          | nenkupton nje periudhe prej 12 muajsh qe fillon ne Daten Efektive ose ne pervjetorin e Dates Efektive;                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Kontrolli                 | Nenkupton te drejten e Autoritetin per te ndjekur zbatimin e Projektit.                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Plani i Korrigjimit       | nenkupton paraqitjen e nje plani te ndryshem nga ai i miratuar nga palet, si rezultat i mosrealizmit te planit ekzistues ne sigurimin e Sherbimeve.                                                                                                                                                                                                                 |
| Vonesa                    | nenkupton periudhen e kohes ne te cilen zbatimi i detyrimeve, vonohet me faj tej afateve te percaktuara ne kete Kontrate.                                                                                                                                                                                                                                           |
| Konfliktet                | nenkupton çdo mosmarreveshje, ndryshim ose çeshtje interpretimi qe del nga kjo Kontrate, duke perfshire çdo mosperputhje, ndryshim ose çeshtje                                                                                                                                                                                                                      |

|                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|--------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                      | interpretimi ne lidhje me percaktimet e bera ne kete Kontrate, mosrenia dakord ne perputhje me Proçedurat e Kontrollit te Ndryshimit ose çdo çeshtje ku kjo Kontrate i drejton Palet te zgjidhin çeshtjen duke ju referuar Proçedures se Zgjidhjes se Konflikteve;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Proçedura e Zgjidhjes se Konflikteve | nenkupton proçeduren e zgjidhjes se konflikteve percaktuar ne Aneksin 10 (Proçedura e Zgjidhjes se Konflikteve);                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Dokumentimi                          | nenkupton pershkrimet e Sherbimeve dhe Niveleve te Sherbimeve, percaktime te hollesishme teknike, manuale perdorimi, manuale operimi, perkufizime dhe proçedura te proçeseve, dhe çdo dokument tjetër i tille siç: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) eshte kerkuar te paraqitet nga Konçesioneri per Autoritetin bazuar ne kete Kontrate;</li> <li>(b) eshte kerkuar nga Konçesioneri me qellim qe te siguroje Sherbimet; ose</li> <li>(c) ka qene ose do te krijohet me qellim sigurimin e Sherbimeve;</li> <li>(d) si dhe cdo pasqyrim i procedurave te kontrollit, monitorimit, procesverbale si dhe dokumentacioni dhe procedurat e nevojshme te hartuara nga Palet gjate zbatimit te kesaj Kontrate.</li> </ul> |
| Data Efektive                        | nenkupton daten ne te cilen kjo Kontrate hyn ne fuqi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Data e nenshkrimit                   | nenkupton daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate nga Palet;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Vit financiar                        | nenkupton nje periudhen qe fillon çdo vit me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetorin ne vijim;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Forca Madhore                        | çdo shkak qe prek permbushjen nga ana e njerës Pale te detyrimeve te saj qe rrjedhin nga aktet, ngjarjet, perjashtimet, ndodhite pertej kontrollit te arsyeshem te saj, duke perfshire pa kufizim aktet e pashpjegueshme, trazirat, luften apo konfliktet e armatosura, aktet e terrorizmit, zjarret, permbytjet, stuhite ose termetet apo fatkeqesite, etj., si dhe cdo rrethane apo ngjarje tjeter e pranuar si e tille nga palet.                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Praktikat Bashkekohore               | nenkupton ushtrimin, kujdesin, perkujdesjen, efektivitetin ose veprimtari te tjera te cilat synojne                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |

|                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|---------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                           | zhvillimin dhe persosmerine e Projektit ne sherbim te realizimit te qellimit te Koncesionit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Njohurite                 | nenkupton te gjitha idete, konceptet, skemat, informacionin, njohurite, teknikat, metodologjite, dhe çdo gje tjeter ne natyren e njohurive qe lidhet me qellimin e realizimit te Koncesionit.                                                                                                                                                                                                                          |
| Afati                     | nenkupton periudhen brenda se ciles nje detyrim te percaktuar ndermjet Paleve, duhet te permbushet.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Muaji                     | nenkupton nje muaj kalendarik dhe "Mujore" do te interpretohet ne menyren e duhur;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Sigurimi i Kontrates      | nenkupton garancine qe duhet te jepet nga Koncesioneri ne perputhje me Nenin 32 dhe Aneksin 11.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Plani i Projektit         | nenkupton planin e percaktuar me hollesi ne Aneksin 10 (Plani i Projektit)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Te Ardhurat               | nenkupton te ardhurat e siguruara ne kuader te veprimtarive tregtare te Koncesionerit nga ky Projekt.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Data e Rishikuar e Afatit | nenkupton çdo date te rishikuar e cila eshte percaktuar per arritjen e nje Afatit;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Aneks                     | nenkupton nje shtojce ndaj kesaj Kontrate Koncesioni qe formon nje pjese integrale dhe te pandare te saj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Mospermbushje             | nenkupton nje suate ne te cilen secila prej Paleve nuk ka arritur te permbushet detyrimet e percaktuara ne kete Kontrate.                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Sherbimet                 | nenkupton te gjitha sherbimet e percaktuara ne Aneksin 2 (Kerkesat e Autoritetit), Aneksin 3 (Oferta e Koncesionerit) si dhe cdo veprimtari tjeter qe synon realizimin e Projektit.                                                                                                                                                                                                                                    |
| Ent shteteror             | nenkupton cilendo ministri apo departament ose çfaredo autoriteti administrativ, civil apo ushtarak te Qeverise se Republikes se Shqiperise apo nenndarjet administrative te Qeverise se Shqiperise duke perfshire pa kufizim cilendo organ dhe cilendo shoqeri, organizate publike apo ent tjeter te zoteruar apo te kontrolluar drejtperdrejt apo ne menyre te terthorte nga, ose qe vepron per llogari apo perfitim |

|                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                                 | te cilesdo agjenci te Qeverise se Republikes se Shqiperise, duke perjashtuar ketu Autoritetin Kontraktues;                                                                                                                                                                                                                     |
| Nen-kontrata                                                                                    | nenkupton çdo marreveshje te lidhur ndermjet Konçesionerit dhe çdo pale te trete per te siguruar Sherbimet ose çdo pjese te tyre ose lehtesite apo sherbimet e nevojshme per sigurimin e Sherbimeve, apo çdo pjese te tyre ose e nevojshme per administrimin, drejtimin ose kontrollin e Sherbimeve ose çfaredo pjese te tyre; |
| Nen-kontraktori                                                                                 | nenkupton palen e trete me te cilen Konçesioneri lidh nje Nen-kontrate.                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Njoftim Zgjidhjeje                                                                              | nenkupton nje njoftim me shkrim te dhene ne perputhje me kete Kontrate, per te perfunduar kete Kontrate e cila do te parashtroje si minimum nje arsye per zgjidhjen;                                                                                                                                                           |
| Testet dhe Testimi                                                                              | çdo testim qe kerkohet te behet bazuar ne kete Kontrate, sikurse eshte pershkruar me tej ne Aneksin 9 (Plani i Testimit);                                                                                                                                                                                                      |
| Data e Nënshkrimit                                                                              | nenkupton daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate nga Palet                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Vendim per Miratimin e Kontratës per dhenien me koncesion te aktivitetit per prodhimin e krupes | është data e miratimit te koncesionit nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes ne zbatim te Ligjit nr. 9663 date 18.12.2006 "Per koncesionet" (i ndryshuar);                                                                                                                                                       |
| Kompensim monetar detyrimesh                                                                    | Nenkupton te drejten qe gezon secila Pale per te kompensuar detyrimin e saj monetar me detyrimin qe ka Pala e tjere, duke e konsideruar detyrimin e saj si te permbushur deri ne masen e kompensuar.                                                                                                                           |
| Faza Operacionale                                                                               | Nenkupton periudhen kohore ne te cilen Konçesionari do te kryej aktivitetet e indentifikuar si të tilla ne Planin e Projektit                                                                                                                                                                                                  |
| Asete                                                                                           | nënkupton pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme të Koncesionarit dhe/ose Shoqërise Koncesionare, të krijuar gjatë periudhës se Koncesionit sipas aktivitetit të ushtruar në përputhje me këtë kontratë dhe qe jane ne sherbim te Projektit.                                                                                  |
| Projekt                                                                                         | Nenkupton te gjitha studimet fillestare dhe perfundimtare te paraqitura nga Koncesionari dhe te                                                                                                                                                                                                                                |

|                                          |                                                                                                                                                                                                                                                |
|------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                          | miratuara nga Autoriteti.                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>Vlerë Investimi</b>                   | nënkupton vlerën e investimit per realizimin e projektit nga koncesionari sipas nenit 15.1 dhe 15.2 te kesaj kontrate                                                                                                                          |
| <b>Projekt</b>                           | Si dhe cdo projekt tjetër qe me miratim te dy palevedo te krijohen nga koncesioni.                                                                                                                                                             |
| <b>Dem</b>                               | Nenkupton demin qe duhet te shperblehet nga pala debitore per mosekzekutim e detyrimit sipas percaktimit te bere ne Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, neni 486.                                                                         |
| <b>Sigurim i Financimit te Projektit</b> | Nenkupton dorezimin e nje dokumenti nga nje institucion financiar vendas ose te huaj, ose nga vete Koncesionari ose te nje marreveshje per investim nga nje Pale e Trete, qe garanton sigurimin e mjeteve monetare per realizimin e projektit. |
| <b>Projekt Perfundimtar</b>              | Nenkupton projektin e pergatitur nga Koncesionari dhe i miratuar nga Autoriteti per realizimin e Koncesionit sipas Aneksit 8.                                                                                                                  |



## **Aneksi 4**

### **Çeshtje Financiare dhe Sqarime Teknike**

#### **Penalitetet e Zbatueshme për Koncesionarin**

Konçesioni do t'i paguaje Autoritetit Pagesat e Voneses si vijon:

#### **1. Themelimi i shoqërisë së re koncesionare për zbatimin e projektit**

Konçesioni do t'i paguaje Autoritetit një penalitet prej 5,000 Euro për çdo javë të plote në të cilën Konçesioni deshton në themelimin e shoqërisë së re koncesionare. Shoqëria koncesionare do të krijohet nga bashkimi i përkohshëm të shoqërive "Albsale" SH.A., "Hodaj" SH.P.K., "Ansi" SH.P.K., "V&K" SH.P.K. dhe "Oro DI Sicilia" s.r.l.

#### **2. Paraqitja e Plan Projektit Perfundimtar pranë Autoritetit Kontraktor.**

Konçesioni do t'i paguaje Autoritetit një penalitet prej 30,000 Euro për çdo javë të plote në të cilën Konçesioni deshton të paraqitjen pranë Autoritetit të Plan Projektit Perfundimtar (siç përcaktohet në Aneksin 8):

#### **3. Aplikimi për Leje, Autorizime dhe/ose Licensa për efekt të Fillimit të Punimeve**

Konçesioni do t'i paguaje Autoritetit një penalitet prej 10,000 Euro për çdo javë të plote në të cilën Konçesioni deshton në Aplikimin për Leje, Autorizime dhe/ose Licensa për efekt të Fillimit të Punimeve (siç përcaktohet në Aneksin 8):

#### **4. Fillimi i Punimeve**

Konçesioni do t'i paguaje Autoritetit një penalitet prej 20,000 Euro për çdo javë të plote në të cilën Konçesioni deshton në fillimin e punimeve (siç përcaktohet në Aneksin 8):

#### **5. Zbatimi i Punimeve**

Ne zbatim te mbi realizimin e punimeve, nese Koncesionari deshton ne realizimin e punimeve do te aplikohen keto penalitete:

- a. Per cdo dite vonese te investimeve sipas grafikut te paraqitur ne oferte do te penalizohet me 0.01% te vleres se investimit te mbetur.
- b. Per cdo dite vonese te perfundimit te punimeve sipas afatit te paraqitur ne oferte, te penalizohet me 500 Euro/dita.
- c. Per mosplotesim te sasise se prodhimit te kripes sipas ofertes se paraqitur, me nje tolerance deri ne 20%, penalizohet me 20,000 Euro.
- d. Per mosplotesim te cilesise se kripes sipas ofertes se paraqitur, penalizohet me 15 000 Euro.

### **Sqarime Teknike**

#### **1. Menyra dhe sasia e prodhimit.**

Palet bien dakort qe prodhimi i deklaruar ne oferte do te jete i pandryshueshem ne sasi e ne cilesi por duke marre ne konsiderate faktoret e kerkeses per treg apo per perdorim te ketij prodhimi. Kjo do te thote qe, ne bilancet e fundit te vitit, koncesionari do te dokumentoje ne total qe shuma prej 340,000 ton prodhim kripe eshte e barabarte me prodhimin plus shitje (evadimin) plus gjendjen faktike e ketij prodhimi. Prodhimi fillestar do te realizohet jo brenda nje viti kalendarik por palet do te konsiderojne prodhimin brenda te gjithe cikleve qe nevojiten per realizimin e produktit final.

Per efekt te perlogaritjeve se sasise se prodhimit vjetor te kripes prej 340.000 ton dhe te pergjegjesise se Koncesionarit ndaj realizimit te kesaj sasie, do te merret ne konsiderate fakti qe kjo sasi eshte e arritshme vetem nese plotesohen kushtet teknike te meposhtme:

1. Duke shfrytezuar rritjen e gradacionit te ketij liqeni nga 3,5 Be' deri ne 8 Be'. Kjo jep mundesi per rritjen e siperfaqes se kristalizimit dhe rrjedhimisht edhe te prodhimtarise se kripores duke shfrytezuar 220-240 ha siperfaqe kristalizuese.
2. Per te siguruar gradacionin e Liqenit te Nartes ne vlerat e mesiperme, del domosdoshmeri menjanimi i derdhjes se ujrave te embla nepermjet Kanalit KK1, dhe Hidrovorit te Gorices ne kete liqen, prurjet e te cilave ulin ndjeshem densitetin e shellires, i cili ne periudhen Mars, Prill, Maj arrin vleren 2-2,5 Be' nga 3,5 Be' qe duhet

te jete densiteti fillestar i fillimit te procesit ne kripore. Kjo disfavorizon ndjeshem prodhimtarine e kerkuar.

3. Bashke me ujrat e embla ne liqen behet dhe shkarkimi i mbetjeve dhe ujrave te zeza, ndotja prej tyre e ujit te liqenit duhet te shmanget.
4. Nje nder kushtet kryesore per sigurimin e prodhimtarise se projektuar, jane faktoret atmosferike:
  - (i) Era ; Ne nje vit prodhimi , ka rendesi te vecante ne procesin e kristalizimit, shpejtesia e eres, drejtimi i saj;
  - (ii) Avullimi; Cikli i prodhimit presupozon shfrytezimin e vlerave optimale te avullimit te dobishem ne periudhen 1Prill-30 Shtator. Sipas ecurise se vlerave te avullimit te dobishem, qe perbejne dhe kushtin kryesor ne sigurimin e spesorit optimal, percaktohet dhe prodhimtaria maksimale e llogaritur.
  - (iii) Rreshjet; Sasia e Rreshjeve vjetore te jene ne vlerat e rreshjeve mesatare te llogaritura per periudha disavjecare.

## **2. Menyra e zbatimit te punimeve.**

